

Petrit Hysa




**PROKUROR PRANË PROKURORISË
SË RRETHIT GJYQËSOR TIRANË**

Deklaratat e analizuara:

16 Deklarata të analizuara

(nga deklarimi Për Herë të Parë 2003 deri
Periodik/Vjetor 2018)

Ndryshimi i pasurisë nga fillimi i deklarimit deri në vitin 2018




Pasuria bruto nga fillimi i detyrës deri me datë 31.12.2018 është rritur 1.9 herë

+ 505,574 Lekë rritja mesatare vjetore e pasurisë


Ndryshimi i pasurisë sipas kategorive

Vlera në Lekë


**Likuiditete
në Bankë**




**Likuiditete
në Cash**



**Pasuritë e
Luajtshme**



**Pasuritë e
Paluajtshme**



Të ardhurat familjare të krijuara gjatë periudhës deklaruese

Të Ardhurat 2004-2018	Shuma në Lekë	Raporti në %
Paga nga funksioni	14,906,184	64.0%
Paga e bashkeshortes	8,375,540	36.0%
Total	23,281,724	100%



Kontrolli Aritmetik dhe Logjik

Kontrolli Aritmetik dhe Logjik për 15 vite rezultoi:

1 Me probleme
14 Pa Probleme

Subjekti Petrit Hysa gjatë periudhës deklaruese 2003 - 2018 ka pasqyruar në mënyrë jo të qartë ndryshimin e gjendjes së kursimeve cash. Në deklarimin për herë të parë deklaroi kursime nga puna ndër vite 5 milion lekë dhe deri në vitin 2010, nuk deklaroi asnjë pakësim të likuiditeteve.

Deklarimi Periodik/Vjetor 2010 përmbledh transaksione të kryera nga ana e subjektit nga viti 2006 deri 2009, por që nuk janë deklaruar në formularin e vitit përkatës. Konkretisht, subjekti deklaroi se ka porositur apartament me sipërfaqe 95.26 m2 me vlerë 74,000 euro. Ka paguar 47,500 euro në vitin 2006 dhe 12,500 euro në vitet në vazhdim deri në v. 2009. Për këto pagesa janë përdorur hua prej 14,000 eurosh dhe 27,000 euro. Pjesa tjetër buron nga mbyllja e depozitës në bono thesari të bashkeshortes dhe gjendja cash e akumuluar. Detyrimi i mbetur firmës 10,000 euro me rastin e hipotekimit." Në asnjë nga vitet e mëparshme nuk deklarohen bono thesari në emër të bashkeshortes apo pakësim i gjendjes cash.

Huamarrja prej 14,000 dhe 27,000 euro personave të tretë pa interes dhe pa afat, mbetet e pashlyer në totalin prej 31,000 euro me datë 31.12.2018.